



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar / Punëpunë / Pr. dato / Received / Delivery	05-05-2021	viti / god / year	1
Organ / Shërbimi / Organ / Shërbimi / Org / Unit	Nr. Prot. / Pr. No.	Shtesa / Protog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMBACI	2187/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.294/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.294/2021 të datës 22.04.2021 të parashtruar nga ankuesja _____ më adresë banimi rruga "Bulevardi Çekaj", fshati Izniq, në Komunën e Deçanit, kundër organit të punësimit Komuna e Deçanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

SHPALLET jo kompetent Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur për ankesën me numër A.nr.294/2021 të datës 22.04.2021 të parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja, _____ me datë 08.03.2019 ka lidhur kontratën e punës ne kohë të caktuar ne afat prej 6 muajsh (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta), me Komunën e Deçanit.

Ankuesja, _____ nuk e ka pranuar pagën sipas kontratës së punës ne kohë të caktuar të datës 08.03.2019, të cilën ka qenë e obliguar t'ia paguaj Komuna e Deçanit.

Ankuesja kundër mos pagesës së pagave nga Komuna e Deçanit, me datë 23.02.2021, ka bërë kërkesë për kompensim e pagave të përcaktuara tek Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit .

Ankuesja me datë 16.04.2021, me ankesë i është drejtuar Inspektoratit të Punës, ndërsa me datë 16.06.2021 Inspektoratit nxjerr vendim me numër Nr.208 me të cilin shpallet jo kompetent për ta shqyrtuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 16.04.2021 të Inspektoratit të Punës, më datë 22.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1946/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga provat e ofruara nga ankuesja ka konstatuar se nuk është e nevojshme të kërkohen prova tjera nga organi i punësimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1946/2021 e datës 22.04.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Inspektoratit të Punës i datës 16.04.2021; Ankesa/kërkesa e datës 16.04.2021 drejtuar Inspektoratit të Punës; Kërkesa e datës 23.02.2021 drejtuar Komunës së Deçanit si dhe kontratën e punës ne kohë të caktuar (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta), nr.7252, të datës 08.03.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është *kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar që ankuesja ka lidhur kontratën e punës me numër Nr.7252, të datës 08.03.2019 në kohë të caktuar ne afat prej 6 muajsh (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta), me Komunën e Deçanit. Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kategoria e të punësuarve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk hyn në kategorinë e shërbyesve civil apo të punësuarve në shërbimin civil, pasi që kontratat për shërbimet e veçanta lidhen në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës nga ankuesja, e i cili përcakton se: *"Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtë se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime..."*, po ashtu neni 84 i Ligji Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë përcakton se: *"Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik"*, rrjedhimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kompetencë që ti shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *"Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën

e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.294/2021

Hysni MUSTAFA

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

